



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

**RREGULLORE Nr.12/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSMIN E RREGULLORES  
Nr.13/2024 PËR STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHE KLASIFIKIMIN E POZITAVE TË  
SEKRETARIATIT TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

Prishtinë, 30.09.2025

## **Këshilli Gjyqësor i Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 7, paragrafi 1, pika 1.24 të Ligjit Nr. 06/L- 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 121 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2025,

### **Miraton:**

## **RREGULLORE Nr.12/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr.13/2024 PËR STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHE KLASIFIKIMIN E POZITAVE TË SEKRETARIATIT TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.13/2024 për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

### **Neni 2**

1. Në nenin 6, paragrafi 4 të Rregullores bazë, pas fjalës “ligj”, shtohet fjalia me tekstin si në vijim “dhe aktet normative të miratuara në Këshill”.
2. Neni 6, paragrafi 5 i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:
  5. Paga e Zyrtarit të lartë ekzekutiv, caktohet sipas akteve të miratuara në Këshill, për klasifikimin e vendeve të punës për nëpunësit civil në administratën e sistemit gjyqësor

### **Neni 3**

1. Në nenin 9, paragrafi 1, nënpika 1.2.3 të Rregullores bazë, emërtimi i pozitës “Zyrtari i lartë për përkthime” zëvendësohet me emërtimin “Zyrtar për përkthime”.
2. Në nenin 9, paragrafi 1, nënpika 1.2.5 të Rregullores bazë, emërtimi i pozitës “Zyrtari për transport” zëvendësohet me emërtimin “Zyrtar për transport (shofer)”.
3. Në nenin 9, paragrafi 1, nënpika 1.2.6 të Rregullores bazë, emërtimi i pozitës “Zyrtari për Arkiva” zëvendësohet me emërtimin “Zyrtar për Arkiv”.
4. Në nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores bazë, pas nënpikës 1.2.3 shtohet nënpika 1.2.4 me emërtimin e pozitës si në vijim:

#### 1.2.4. Zyrtar i lartë i personelit.

5. Në nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores bazë, ndryshohet renditja e pozitave, ashtu që nënpika 1.2.4, renditet si nënpikë 1.2.5, nënpika 1.2.5, renditet si nënpikë 1.2.6 dhe nënpika 1.2.6, renditet si nënpikë 1.2.7.
6. Në nenin 9, paragrafi 3, pika 3.1, pas nën paragrafit 1.2, shtohet nënpika 1.2.1 sipas renditjes në Rregulloren bazë.
7. Në nenin 9, paragrafi 3, pika 3.2, pas nënpikës 1.2.6, shtohet nënpika 1.2.7, sipas renditjes në nenin 2, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.
8. Në nenin 9, paragrafi 4, pika 4.1, pas nën paragrafit 1.2, shtohet nënpika 1.2.1 sipas renditjes në Rregulloren bazë.
9. Në nenin 9, paragrafi 4, pika 4.2, pas nënpikës 1.2.6, shtohet nënpika 1.2.7, sipas renditjes në nenin 2, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 4**

Neni 12 i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 12 Dispozita kalimtare**

Jo më vonë se tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, do të nxjerr akt emërimet e reja, për të gjitha pozitat në PZAP, duke i harmonizuar me titujt e përcaktuar me këtë rregullore, si dhe aktet normative për klasifikimin e vendeve të punës për nëpunësit civil në administratën e sistemit gjyqësor.

### **Neni 5**

Neni 14 i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 14 Shtojcat**

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është organogrami i Sekretariatit të PZAP, i cili paraqitet në Shtojcën 1, si dhe Lista e klasifikimit të pozitave në Sekretariatit të PZAP, e cila paraqitet në Shtojcën 2, ndërsa Shtojca Nr.1 - Organogrami i Sekretariatit të PZAP dhe Shtojca Nr. 2 - Klasifikimi i pozitave në Sekretariatit të PZAP, të Rregullores bazë, fshihen.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**


Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

**Albert Zogaj,**

\_\_\_\_\_  
**Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës**

**Datë:** \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

## Shtojca Nr.1 - ORGANOGRAMI





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
**SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL**

---

**SHTOJCA Nr. 2 - LISTA E KLASIFIKIMIT TË POZITAVE NË SEKRETARIATIN  
E PZAP-së.**

| <b>Nr.</b> | <b>POZITA E PUNËS</b>                                                                                                    | <b>KLASA</b>                                                        | <b>KOEFICIENTI</b>                                                  | <b>KATEGORIA</b>          |
|------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|---------------------------|
| <b>1</b>   | <b>Drejtori i SPZAP-it</b>                                                                                               | <b>Sipas akteve<br/>përkatëse të<br/>miratuara<br/>nga Këshilli</b> | <b>Sipas akteve<br/>përkatëse të<br/>miratuara nga<br/>Këshilli</b> | <b>Drejtues i Lartë 2</b> |
| <b>2</b>   | <b>Zyrtar i Lartë<br/>Ekzekutiv</b>                                                                                      | <b>J14</b>                                                          | <b>7.5</b>                                                          | <b>Profesional 1</b>      |
| <b>3</b>   | <b>Zyrtar i lartë për<br/>informim dhe<br/>komunikim</b>                                                                 | <b>J14</b>                                                          | <b>7.5</b>                                                          | <b>Profesional 1</b>      |
| <b>4</b>   | <b>Drejt看 i<br/>Departamentit ligjor</b>                                                                                 | <b>J12</b>                                                          | <b>12.3</b>                                                         | <b>Drejtues i Mesëm 1</b> |
| <b>5</b>   | <b>Udhëheqës i divizionit<br/>për hartim të<br/>legjislacionit,<br/>mbështetje ligjore dhe<br/>shqyrtimin e ankesave</b> | <b>J9</b>                                                           | <b>9.4</b>                                                          | <b>Drejtues i Mesëm 2</b> |

|    |                                                                                              |     |      |                    |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----|------|--------------------|
| 6  | Zyrtar i Lartë për hartim ligjor, shqyrtimin e ankesave dhe përgatitjen e paneleve           | J14 | 7.5  | Profesional 1      |
| 7  | Zyrtar për hulumtime dhe analiza ligjore të kontesteve zgjedhore                             | J15 | 5.85 | Profesional 2      |
| 8  | Udhëheqes i Divizionit për koordinim, bashkëpunim ndërinstitucional, mbikëqyrje dhe raportim | J9  | 9.4  | Drejtues i Mesëm 2 |
| 9  | Zyrtar për koordinim dhe bashkëpunim ndërinstitucional                                       | J15 | 5.85 | Profesional 2      |
| 10 | Zyrtar për mbikëqyrje ligjore dhe raportim                                                   | J15 | 5.85 | Profesional 2      |
| 11 | Drejtues i Departamentit për buxhet, financa dhe shërbime të përgjithshme                    | J12 | 12.3 | Drejtues i Mesëm 1 |
| 12 | Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa                                                        | J14 | 7.5  | Profesional 1      |

|           |                                                                                       |            |             |                           |
|-----------|---------------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------|---------------------------|
| <b>13</b> | <b>Udhëheqës i Divizionit<br/>për shërbime të<br/>përgjithshme dhe<br/>logjistike</b> | <b>J9</b>  | <b>9.4</b>  | <b>Drejtues i Mesëm 2</b> |
| <b>14</b> | <b>Zyrtar për Përkthime</b>                                                           | <b>J14</b> | <b>7.5</b>  | <b>Profesional 1</b>      |
| <b>15</b> | <b>Zyrtar i lartë i<br/>personelit</b>                                                | <b>J14</b> | <b>7.5</b>  | <b>Profesional 1</b>      |
| <b>16</b> | <b>Zyrtar i Teknologjisë<br/>Informative</b>                                          | <b>B7</b>  | <b>10</b>   | <b>Ekspert</b>            |
| <b>17</b> | <b>Zyrtar për transport<br/>(shofer)</b>                                              | <b>J16</b> | <b>5.3</b>  | <b>Profesional 3</b>      |
| <b>18</b> | <b>Zyrtar për Arkiv</b>                                                               | <b>J15</b> | <b>5.85</b> | <b>Profesional 2</b>      |